



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 3471/8 / prot.

Tiranë, më 0.12.2021

URDHËR

Nr. 677, Datë 10.12.2021

**“PËR
MARRJEN NË DORËZIM TË REGJISTRAVE DHE AKTEVE NOTERIALE, TË ISH
NOTERIT MAREGLEN DALIPI”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7 të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, Urdhrit nr.167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”,

KONSTATOJ:

Me Urdhrin nr. 491, datë 20.08.2021, të Ministrit të Drejtësisë është vendosur heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit z. Mareglen Dalipi, pasi nga ana e tij nuk ushtrohej veprimtaria noteriale për një periudhë kohore më shumë se 1 (një) vit.

Në këto kushte, lind nevoja për ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të regjistrave dhe akteve noteriale, të ish-noterit z. Mareglen Dalipi, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe mospengimin e shtetasve për pajisjen me akte noteriale të cilat ndodhen në arkivën e ish noterit, si dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës së thatë dhe të njomë të ish-noterit.

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për noterinë”, në pikën 1 dhe 2 të Urdhrit nr. 167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”, si dhe pas administrimit të shkresës nr. 3471/5, datë 02.09.2021 Dega Vendore e Noterisë Durrës dhe shkresës nr. 3425 prot., datë 01.11.2021 të Dhomës Kombëtare të Noterisë,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të arkivës noteriale të ish-noterit z. Mareglen Dalipi, i përbërë nga antarët e mëposhtëm:

- a) Znj. Erisa Sulçe, Sektori Rregullimit të Profesioneve të Lira, në Ministrinë e Drejtësisë;
- b) Noterja, znj. Majlinda Lato, përfaqësuese e Degës Vendore të Noterisë Durrës;
- c) Noteri, z. Fatmir Laçej, përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

2. Ish-noteri, personi i autorizuar prej tij përmes prokurës së posaçme ose personi që ka në ruajtje arkivën i dorëzon regjistrat, aktet noteriale dhe vulat përkatëse Komisionit të ngritur në pikën 1 të këtij urdhri, në ditën dhe orën që është caktuar në marrjen e njoftimit përkatës.

3. Komisioni për marrjen në dorëzim të arkivës, merr në dorëzim me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë antarët dhe noteri, regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit dhe vulat përkatëse.

4. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, anëtarët e komisionit të caktuar në pikën 1, të këtij urdhri, të verifikojnë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojnë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

5. Arkiva t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noteres, së Degës Vendore të Noterisë Durrës **znj. Anduela Elezi**, pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noterja plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

6. Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri kryen dorëzimin e regjistrave dhe akteve noterial noteres **znj. Anduela Elezi**, të caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Durrës, si dhe kryen asgjësimin e vulës së thatë dhe vulës së njomë, të ish-noterit Mareglen Dalipi.

7. Ngarkohet Sektori Arkiv – Protokollit për njoftimin e këtij urdhri personit përgjegjës si dhe ish-noterit Mareglen Dalipi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
ULSI MANJA

